

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ BLERJE BUKË,FRUTA, PERIME E TE TJERA PËR  
KAFSHËT E KOPSHTIT ZOOLOGJIK PËR VITIN 2025”**

**REF-43265-04-02-2025**

**Loti I-rë:      Objekti: “Blerje bukë, fruta, perime, e të tjera për kafshët e Kopshtit  
Zoologjik “**

**Loti II-të:    Objekti: “ : “Blerje drithërash, koncentratesh e të tjera për kafshët e Kopshtit  
Zoologjik“**

Loti I-rë: REF-43268-04-02-2025

Loti II-të: REF-43270-04-02-2025

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
03221200-8 (perime-fruta)  
15811100-7 (Buke)**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Loti I-rë: ‘Blerje bukë, fruta, perime, e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik “**

**Fondi limit: 2 576 105** *(dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesë) Lekë pa TVSH*

**Loti II-të: “Blerje drithërash, koncentratesh e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik“**

**Fondi limit: 6 590 562***(gjashtë milion e pesëqind e nentëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy )Lekë pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor, **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti I-rë: ‘Blerje bukë, fruta, perime, e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik ‘**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 4 në vlerën Loti I: **51 522.10** (pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e dy pikë dhjetë) **Lekë**.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen *Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:***

- II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, e cila te perfshije minimalisht nje nga artikujt objekt prokurimi.

*Kriteri si me siper bazohet sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,pika 1a/ dhe 2 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Neni 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.**

Gjithashtu në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar përcaktohet se:

”Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

**2.1.2. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues**, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik: **ISO 9001:2015** certifikatën e menaxhimit të cilësisë; Për prodhimin ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

**ISO 22000:2018** për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore; Për prodhimin ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë pasi është ushqim, është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar mallrat që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes*

*Kriteri si me sipër bazohet sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbyshje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (**bilancet**) **gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore.** Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbyshur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"i ndryshuar.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. *Ky kriter konsiderohet i përmbyshur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbyshjen me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore **për Vitin 2025** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor; përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Shënim:**

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, sa shuma e përlogaritur e vlerës së fondit limit të loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

**a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

**b) Për furnizime të realizuara me subjekte private** operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të ulët se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur e thjeshtuar të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.2** OE të ketë në staf të paktën **2 (dy) punonjës shoferë** të cilët duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë me kodin përkatës, për të gjithë periudhën e kërkuar janar 2025 - mars 2025.

Lidhur me këtë pikë, kandidati/operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Administrata Tatimore), në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për çdo muaj, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar. Operatori Ekonomik Ofertues, gjithashtu duhet të paraqesë Listepagesat përkatëse E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për **periudhën janar 2025 – mars 2025 sipas legjislacionit në fuqi.**

**Shënim:** Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në natyrën e objektit të prokurimit. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë për realizimin e objektit.

**2.3.3** Deklarate nga ana e Operatorit Ekonomik Ofertues, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave/artikujve objekt prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor, në ditët, oraret dhe sasi të kërkuara dhe dakordësuara mes palëve.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet **transporti ATP**, në pronësi/qira/përdorim sipas kontratës noteriale, për të cilin duhet të paraqitet në tender dhe të vërtetohet:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit/marrjen me qira/përdorimin me huapërdorje.
- Leje qarkullimi e mjetit.
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit.
- Leje higjieno sanitar të mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

*Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi sasive ushqimii, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.



**2.3.5** Operatori Ekonomik Ofertues duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për plotësimin e kësaj pike, shoqëria duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në fuqi.

Operatori Ekonomik i shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i kryer i fundit nga AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, referuar kjo sipas rekomandimit të përbashkërt të APP dhe AKU. Gjithashtu, çdo operator ekonomik ofertues duhet ta administrojë këtë dokument, për verifikim, në rast se do të lindi nevoja.

**ARGUMENTIMI:** Nisur nga fakti që respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore është shumë i rëndësishëm, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, OE detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i kryer i fundit nga AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore

***Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të specifikohet që jemi dakort me këtë deklaratë.***

**SHËNIM:** Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Veglat e punës profesionale janë mjete teknike të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor të cilat janë të dedikuara për procese pune specifike. Një pjesë e produkteve duhet të garantojnë sigurinë e funksioneve speciale të tyre sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo standart teknik të kërkuar në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Loti II-të:” Blerje drithërash koncentratësh e të tjera për kafshët e Kopshtit Zoologjik »**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 përketesisht në vlerën Loti II: 131 811, 24 (njëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë pikë njëzet e kater) Lekë*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1.1 Operatori ekonomik te paraqesë licencen *Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:***

- II.1.A.2 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”. dhe

- II.1.A.3 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”.

*Kriteri si me sipër bazohet sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,pika 1a/ dhe 2 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.1.2. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues,** duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose

ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik: **ISO 9001:2015** çertifikatën e menaxhimit të cilësisë; Për prodhimin ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

**ISO 22000:2018** për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore; Për prodhimin ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë pasi është ushqim, është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar mallrat që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes*

*Kriteri si me sipër bazohet sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (**bilancet**) **gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore.** Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë

05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore **për Vitin 2025** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Shënim:** *Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Shënim:**

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, sa shuma e përlllogaritur e vlerës së fondit limit të loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

**a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

**b) Për furnizime të realizuara me subjekte private** operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të ulët se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur e thjeshtuar të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.2** OE të ketë në staf të paktën **2 (dy) punonjës shoferë** te cilet duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë me kodin përkatës, për të gjithë periudhën e kërkuar janar 2025 - mars 2025.

Lidhur me këtë pikë, kandidati/operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Administrata Tatimore), në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për çdo muaj, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar. Operatori Ekonomik Ofertues, gjithashtu duhet të paraqesë Listëpagesat përkatëse E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për **periudhën janar 2025 – mars 2025 sipas legjislacionit në fuqi.**

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në natyrën e objektit të prokurimit. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë për realizimin e objektit.

**2.3.3** Per artikujt me volum te konsiderueshem, **Bar i thate dhe Jonxhe e thate** ditën e hapjes se procedures operatori ekonomik pjesemarres duhe te paraqese nga nje deng per secilin prej ketyre artikujve me qellim krahasimin e tyre me specifikimet teknike dhe njekohesisht te ngarkohet ne sistem deklarate e operatorit ekonomik se **ne rast te shpalljes fitues**, ne momentin e levrimit te mallit do te jete i njejte me mostren e paraqitur.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proceseve të punës duke qenë se kërkohen ushqim për kafshët e kopshtit zoologjik. Në këtë rast janë përzgjedhur disa nga produktet, të konsideruara nga autoriteti kontraktor si të nevojshme për t’u paraqitur si mostra.

**2.3.4 Deklarate nga ana e Operatorit Ekonomik Ofertues,** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave/artikujve objekt prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor, në ditët, oraret dhe sasi të kërkuara dhe dakordësuara mes palëve.

**2.3.5 Deklaratë nga ana e Operatorit Ekonomik Ofertues** që artikujt plotësojnë specifikimet e kërkuara. Në çdo rast, për operatorin ekonomik fitues, AK rezervon të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme (analizat laboratorike) mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik fitues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.

**2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën një mjet **transporti ATP dhe nje mjet transporti KAMION,** në pronësi/qira/përdorim sipas kontratës noteriale, për të cilin duhet të paraqitet në tender dhe të vërtetohet:**

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit/marrjen me qira/përdorimin me huapërdorje.



- Leje qarkullimi e mjetit.
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit.
- Leje higjeno sanitar të mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

*Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi sasive ushqimii, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurrohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t'u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për **kryerjen e furnizimit ATP.**

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit “mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret kemi kërkuar edhe një kamion për natyrën e mallrave objekt prokurimi.

**2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues** duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për plotësimin e kësaj pike, shoqëria duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të

deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në fuqi.

Operatori Ekonomik i shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i kryer i fundit nga AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, referuar kjo sipas rekomandimit të përbashkërt të APP dhe AKU. Gjithashtu, çdo operator ekonomik ofertues duhet ta administrojë këtë dokument, për verifikim, në rast se do të lindi nevoja.

**ARGUMENTIMI:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore si dhe Rekomandimit të Agjencisë së prokurimit publik Nr.10181, datë 19.11.2018 “Mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që ushtrojnë aktivitetin konform kërkesave ligjore, për realizimin me sukses të objektit të prokurimit .

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik ofertues sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të specifikohet që jemi dakort me këtë deklaratë.*

**SHËNIM:** Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Veglat e punës profesionale janë mjete teknike të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor të cilat janë të dedikuara për procese pune specifike. Një pjesë e produkteve duhet të garantojnë sigurinë e funksioneve speciale të tyre sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo standart teknik të kërkuar në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**NJESIA E PROKURIMIT**

- 1. Nadia Muçelli** (*përgjegjës për prokurimin*) sektori i burimeve njerezore dhe sherbimeve)
- 2. Sajmir Shehu** (*Drejtor, Drejtoria e Veterinarisë dhe mirëqënies së Kafshëve*)
- 3. Suela Ndrejaj** (*SBNJSH*)